VENDIM
Nr. 126/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin a/5, "Mbledhjet në rastet e masave të jashtëzakonshme", bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet "Mbledhjet në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik".

2. Në paragrafin e parë pas fjalëve "fatkeqësive natyrore" shtohen fjalët "si dhe në çdo rast tjetër të pamundësisë së zhvillimit fizik të mbledhjeve", si dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët "dhe/ose në mënyrë të kombinuar të prezencës fizike dhe mjeteve të komunikimit elektronik".

3. Në fund të paragrafit të katërt shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Gjithashtu, zhvillimi i mbledhjes së komisioneve parlamentare në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose në mënyrë të kombinuar mund të vendoset edhe nga kryesia e komisionit.".

Neni 2

Në nenin 63 në pikën 1 shkronja "d" riformulohet si më poshtë:

"d) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë.".

Neni 3

Në nenin 65 pika 2 riformulohet si më poshtë:

"2. Në rast se deputeti nuk pranon të dalë nga salla ose përpiqet të hyjë në sallën e seancës plenare/mbledhjes së komisionit, drejtuesi i seancës plenare/komisionit i kërkon Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën marrjen e masës disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë.".

Neni 4

Në nenin 65/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit riformulohet "Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë"".

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

"6. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 30 ditë" jepet në rastet:

a) kur deputeti përdor dhunë ndaj deputetëve të tjerë, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, punonjësve të shërbimit të seancave, të Gardës së Republikës ose punonjësve të medieve.

b) kur deputeti përmes veprimeve të qëllimshme dëmton pajisjet dhe orenditë ose heq funksionalitetin e tyre logjistik në sallën e seancave/mbledhjes.

c) kur deputeti kryen në mënyrë të përsëritur brenda një sesioni parlamentar shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

7. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 60 ditë" jepet në rastet:

a) kur deputeti përdor lëndë apo mjete piroteknike, tymuese, bojëra dhe materiale apo mjete të tjera të ngjashme brenda sallës së zhvillimit të punimeve të Kuvendit/mbledhjes së komisionit /brenda mjediseve të Kuvendit;

b) kur deputeti kryen veprime/sjellje që dyshohet se përmbajnë elemente të veprës penale, të parashikuara në Kodin Penal.

c) kur deputeti kryen në mënyrë të përsëritur brenda një sesioni parlamentar shkeljet e parashikuara në pikën 6.

8. Kërkesa për marrjen e masës disiplinore, sipas pikave 6 dhe 7 të këtij neni, paraqitet me shkrim nga jo më pak se 7 deputetë dhe jo më vonë se 48 orë nga dita e konstatimit të ngjarjeve/rasteve.

9. Gjatë periudhës së zbatimit të masës disiplinore të parashikuar në pikat 6 the 7 të këtij neni deputeti ndalohet të kryejë dhe çdo veprimtari tjetër si anëtar i Kuvendit.".

Neni 5

Në nenin 65/2 pikat 1 dhe 5 riformulohen si më poshtë:

1. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë" jepet nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Mbledhja e Sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës.

5. Vendimi i dhënë për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronjat "a" dhe b", pikat 6 dhe 7 të nenit 65/1 publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja "c", të nenit 65/1 publikimi bëhet vetëm me pëlqimin e personit/viktimë e ngacmimit seksual."

Neni 6

Në nenin 65/3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4 pas fjalës "pezullohet" shtohen fjalët "me vendim të ndërmjetëm të Byrosë së Kuvendit deri në dhënien e vendimit përfundimtar".

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar, më datë 14.12.2023.